



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2360/9 prot.

Elbasan, më 02.11.2021

VENDIM

Nr. 46 datë 02.11.2021

**"PËR
RIORGANIZIMIN E DY NJËSIVE BAZË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË
EDUKIMIT"**

Në mbështetje të nenit 30 pika 6, nenit 38 gërma "ë" të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26 gërma "f", nenit 9 gërma "k" të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", me propozim të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale" dhe njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Edukimit Qytetar" riorganizohen në një njësi bazë të emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar".
2. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale".
3. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Edukimit Qytetar".
4. Njësia bazë e re e emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar" do të jetë përgjegjëse për programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Edukimit Qytetar.
5. Dokumentacioni i Departamentit të Edukimit Qytetar dhe Departamentit të Shkencave Sociale do të administrohen nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar.
6. Ngarkohet Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim t'i përcillet Senatit Akademik për veprime të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Ardian DURMISHI

